

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
AUTORITETIN SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Miratohet:

28.02.2018

Lorenc Çala

Drejtor i Përgjithshëm



PROGRAMI I TRANSPARENCËS

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është përgatitur programi i transparencës për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor - ASIG. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”(këtej e tutje LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (këtej e tutje ASIG) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

ASIG-u, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së, kryen këtë rishikim dhe do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së ASIG, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare, www.asig.gov.al, në Gjeoportalin Kombëtar, <https://geoportal.asig.gov.al>, si dhe në mjediset e institucionit. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentacionin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti, në faqen zyrtare, në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e ASIG-ut është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së ASIG-ut, janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave. ASIG-u ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që buron nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e ASIG-ut dhe përkatësisht: Ligji nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 20.2.2013, për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Urdhri nr. 87 datë 25.07.2013 “Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor”, “i ndryshuar, Rregullorja e brendshme për funksionimin e ASIG-ut, si dhe aktet e tjera nënligjore të dala në zbatim të ligjit.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - të identifikojë autoritetin publik që e ka krijuar;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.asig.gov.al në Gjeoportalin Kombëtar, <https://geoportal.asig.gov.al>, dhe në mjediset e institucionit, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota të: ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve, kodit të etikës, dokumenteve të politikave apo biznes plane, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, manualeve ose dokumenteve të tjera që kanë lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prekin publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera audituese, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për ndërtimin e NSDI në Shqipëri, rolin e ASIG si koordinator i NSDI dhe rolin dhe vendimet e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG).
- Informacion për shërbimet që ASIG-u i jep publikut, përfshirë të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore, metadatat përkatëse, autoritetet publike përgjegjëse për çdo temë, standardet e miratuara dhe përputhshmërinë me “INSPIRE”, rrjetet përbërëse të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në konsultimin për hartimin e akteve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të ASIG-ut, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- ASIG, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga ASIG-u.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË ASIG

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	-Vendim miratimi -Skema e strukturës -Tabelë e funksioneve , detyrave të autoritetit publik dhe kategoria e pagës	1. Me firmosjen nga ana e Kryeministrit 2. Me miratimin e ndryshimit të strukturës. 3. Me çdo ndryshim akti emërimi	Në faqen zyrtare në menunë “Rreth nesh” , “Struktura”	Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
Akte ndërkombëtare ligje; akte nënligjore; dokument politikash; standarde udhëzues teknike dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Konventa -Ligje -Akte nënligjor -Raport vjetor	Pas botimit në Fletoren Zyrtare Pas miratimit nga titullari.	Në faqen zyrtare në menunë “Legjislacioni”	Spektori i Koordinimit

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Format kërkesë Format ankese Shpjeguese Adresë postare Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, Kati 2, Tiranë. E-mail: info@asig.gov.al	Pas miratimit të Programit të Transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në menunë “Programi i Transparencës”	Spektori i Koordinimit Koordinatori për të drejtën e informimit
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Rruga “Papa Gjon Pali II” Nr. 3, Kati 2, Tiranë. Orari: E hënë-e enjte 8.00-16.30 E premte 8.00-14.00	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Në faqen zyrtare në menunë “Kontakte” dhe “Programi i transparencës”	Koordinatori për të drejtën e informimit
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil” I ndryshuar, e aktet nënligjore në zbatim të tij, KPA dhe Ligji organik 72/2012.	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari apo organi kompetent.	Në faqen zyrtare në menunë “Njoftime” dhe “Legjislacioni”	Departamenti Administratës Publike dhe Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
Mekanizmat monitorues; raporte auditimi;	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditimi	Menjëherë pas depozitimit në institucion	Në faqen zyrtare në menunë “Publikime”	Spektori i Financës

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti Statistika	Pas miratimit të ligjit të buxhetit	Në faqen zyrtare në menunë “Njoftime”	Sektori i Financës
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve	Menjëherë pas dërgimit në Agjencinë e Prokurimit Publik	Në faqen zyrtare në menunë “Njoftime”	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
Të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore të ASIG-ut për publikun.	Neni 7/1/f dhe neni 7/dh i ligjit nr. 72/2012	Metadat Temat (shtresat) e të dhënave gjeohapësinore Shërbimet	Përditësohet vazhdimisht sipas afateve në “Plani i Komunikimit”	Në faqen zyrtare në menunë “Gjeoportali”	Drejtoria GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit
Projekte, të dhëna dhe standarde mbi KRGJSH-së.	Neni 7/1/f dhe neni 7/b i ligjit nr. 72/2012	Përmbajtja e projekteve për rrytet e KRGJSH-së Të dhëna Standarde	Përditësohet vazhdimisht sipas afateve në “Plani i Komunikimit”	Në faqen zyrtare në menunë “Publikime”	Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Projekt akte nënligjore dhe mendime mbi iniciativa ligjore	Pas miratimit të nga titullari	Në faqen zyrtare në menunë “Legjislacioni”	Sektori i Koordinimit/ Koordinatori për konsultimin publik
Mbajtja e dokumentacionit nga AP.	Neni 7/1/h	Bazuar në ligjin “Për arkivat”	Sipas afatit të vendosur nga Komisioni i Ekspertizës	Në faqen zyrtare në menunë “Publikime”	Specialisti i Arkivës dhe Protokollit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/i	Formati i regjistrit	Pas miratimit nga titullari të programit të transparencës	Në faqen zyrtare në menunë “Programi i transparencës”	Koordinatori për të drejtën e informimit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Nëpunës civil Shpallje për vende vakante Koeficientet e transformimit	Pas çdo krijimi të vendit vakant.	Në faqen zyrtare të ASIG në menutë “Njoftime” , “Legjislacioni”	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti /përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/1	Trajnime, workshop-e, evente, materiale promovuese	Pas miratimit nga Titullari.	Në faqen zyrtare të ASIG në menutë “ Aktivitete ”, “ Njoftime ”.	Spektori i Koordinimit/ Personi i ngarkuar me zbatimin e planit të komunikimit

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, ASIG-u vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.asig.gov.al, kategoritë (menutë) e cituara më sipër, si dhe një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

KËRKESË PËR INFORMACION (Model)

Emër mbiemër: Z/Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: __. __. 201__ Nënshkrimi:
--------------------------------------	--	---

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

_____ _____ _____ _____ _____ _____ _____ _____
--

Të dhëna të tjera

_____ _____

Forma që kërkohet informacioni/dokumentacioni:

_____ _____

Vetëm për përdorim zyrtar

Data e marrjes: __/__/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____
------------------------------------	---------------------------------	--

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE (Model)

Nr. rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					

Adresa dhe kontakte mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Drejtoni kërkesën tuaj, koordinatori për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.